



## VENDIM

Nr. 16, Datë 26.06.2012

### PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DIPLOMAVE TË STUDIMIT QË LËSHON UNIVERSITETI I ARTEVE

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 26.06.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### VËREN SE

Universiteti i Arteve lëshon disa diploma, në përputhje me ciklet e studimit që zbatohen në këtë shkollë. Senati Akademik miraton formën e Diplomës Bachelor që lëshon Universiteti i Arteve, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 5, datë 18.02.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e Diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar.

Me Udhëzimin nr. 5, datë 06.03.2012 Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka shtuar në përmbajtjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë edhe një element tjetër: "datën e regjistrimit të studentit në institucionin që lëshon diplomën". Ky element duhet të pasqyrohet në Diplomat që lëshon Universiteti i Arteve.

Miratimi i formës dhe përmbajtjes së Diplomës së UART është kompetencë e Senatit Akademik të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë Publik.

Për sa më sipër, bazuar në nenet 26 dhe 31 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 5, datë 18.02.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e Diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar të MASH, si dhe nenin 64 të Statutit të Universitetit të Arteve,

#### VENDOSI

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së Diplomës Bachelor që lëshon Universiteti i Arteve, sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së Diplomës Master i Arteve të Bukura që lëshon Universiteti i Arteve, sipas Lidhjes 2 bashkëlidhur këtij Vendimi.



3. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së Diplomës Master Shkencor që lëshon Universiteti i Arteve, sipas Lidhjes 3 bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së Diplomës Master Profesional që lëshon Universiteti i Arteve, sipas Lidhjes 4 bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**